



YOUTH ASSOCIATION FOR HUMAN RIGHTS
ASOCIACIONI RINOR PËR DREJTAT E NJERIUT



PËRFSHIRJA GJINORE NË INSTITUCIONET LOKALE NË LIPJAN

Maj 2021

COPYRIGHT © 2021. Youth Association for Human Rights (YAHR).

Youth Association for Human Rights i ka të rezervuara të gjitha të drejtat për këtë raport dhe asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të jetë objekt i riprodhimit ose bartjes në asnjë formë mekanike ose elektronike, duke përfshirë fotokopjimin ose ndonjë sistem të ruajtjes ose tërheqjes së materialeve pa autorizimin paraprak të botuesit me shkrim. Publikimi mund të riprodhohet ose të bartet vetëm për qëllime jo komerciale. Kurdo dhe kushdo që ka për qëllim të përdorë fragmente ose materiale të ndryshme të këtij publikimi, është i detyruar ta tregojë qartë burimin sa herë që janë nxjerrë fragmentet ose materialet e përdorura.

Nëse keni ndonjë koment, kritikë ose sugjerim, ju lutemi na kontaktoni përmes ndonjë prej opsioneve të mëposhtme:

Adresa: Rruga Tahir Sinani,

14000, Lipjan,

Kosovë

Tel .: +383 (0) 44 786 414

E-mail: info.yahr@gmail.com

Web: www.ngoyahr.webbly.com

Autor:: Bekim Krasniqi & Ferdian Shala

Faqosja dhe dizajni: YAHR

Ky dokument u përgatit me ndihmën financiare nga Agjencia Austriake për Zhvillim dhe Agjencia Suedeze e Zhvillimit Ndërkombëtar, Sida. Përmbajtja e kësaj analize / materiali është vetëm përgjegjësi e partnerit të projektit / WCSO dhe jo domosdoshmërisht ndan ose reflekton pikëpamjet dhe interpretimet e Agjencisë Austriake të Zhvillimit dhe Sida.

Financuar nga



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave

PËRMBAJTJE

Shkurtesat	3
Hyrje	4
Metodologjia	5
Analizë e përfshirjes gjinore në drejtorin e arsimit	5
Analizë e përfshirjes gjinore në drejtorin e shëndetësisë	8
Analizë e përfshirjes gjinore në drejtorin e administratës	11
Analizë e përfshirjes gjinore në gjykatën themelore të Prishtinës dega në Lipjan	12
Analizë e përfshirjes gjinore në stacionin policore të komunës së Lipjanit	14
Përfundimet	15
Përshkrim për organizatën	16

SHKURTESAT

AMF	Ambulancat e Mjekësisë Familjare
BPGJ	Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
DSH	Drejtoria e Shëndetësisë
KK	Kuvendi Komunal
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QPS	Qendra për Punë Sociale
SHK	Shtëpinë e Komuniteteve
YAHR	Youth Association for Human Rights

HYRJE

Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinator ka një rol të rëndësishëm për komunën e Lipjani por edhe për të gjithë popullsinë pasi që përmes buxhetimit gjinator arrihet të kemi ndarje të barabartë të fondeve për të cilat kontribuon e gjithë shoqëria pa dallim gjinator.

Analiza e buxhetimit të përgjegjshëm gjinator ka për qëllim identifikimin dhe pasqyrimin e pa barazive në institucionet lokale në komunën e Lipjanit.

Institucionet kryesor lokale që veprojnë në Komunën e Lipjanit janë: Kuvendi Komunal , ekzekutivi, Gjykata Themelore e Prishtinës dega në Lipjan, Stacioni Policor, QKMF-ja dhe Qendra për Punë Sociale.

Komuna e Lipjanit ka një territor administrativ i cili është i pozicionuar në jug të Prishtinës, dhe mbulon sipërfaqen prej 338.54 km². Dendësia e popullsisë 170 b/km², e përafërt me mesataren e popullsisë në shkallë vendi 159.31 b/km², 3.2% e territorit të shtetit.

Në regjistrimin e fundit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, numri i përgjithshëm i banorëve në Komunën e Lipjanit është 57.605 banorë.

Pjesa më e madhe e popullsisë janë shqiptarë 94,8 %, ndërsa 0.88 % janë serb, kroatë: 0.41 %, romë: 3.67% dhe 0.03 % të tjerë. Mosha e popullsisë është e re, nga kjo rreth 40% janë të moshës 0 -14 vjeç, 45% janë të moshës 15 -65 vjeç dhe 15% janë të moshës mbi 65 vjeç. Mesatarja e madhësisë së familjeve është pesë anëtarë.

Në këtë analizë hulumtuese janë trajtuar të dhënat të cilat kanë për qëllim identifikimin e pa barazisë gjinore në institucionet lokale në komunën e Lipjanit, duke bërë analizë sasiore, ku përmes kësaj analize janë pasqyruar pabarazitë gjinore në punësim si dhe në përftimet përmes pagave të punësuarve në këto institucione.

Objekt i analizës gjithashtu ka qenë edhe institucionet regjionale me përfaqësim të tyre në formën e degëve , siç është Gjykata Themelore e Prishtinës dega në Lipjan, Stacioni policor, ku janë analizuar duke filluar nga pozitat udhëheqëse deri tek të punësuarit civil brenda këtyre institucioneve.

METODOLOGJIA

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është që të identifikohen pa barazitë gjinore në institucionet lokale të komunës së Lipjanit duke filluar nga 3 drejtorit e komunës së Lipjanit, Gjykatën themelor të Prishtinës dega në Lipjan si dhe stacionin policore në Lipjan, duke filluar nga numri i të punësuarve në këto institucione e deri tek pozitat udhëheqëse të cilat kanë qene objekt i hulumtimit.

Pyetjet kërkimore të këtij hulumtim kanë qenë duke u bazuar në Ligjin për Qasje në dokumente publike:

- Numrin e përgjithshëm të punësuarve në emrin e institucionit në Lipjan;
- Të specifikohen sa janë të punësuar burra dhe sa janë të punësuar gra;
- Sa pozita udhëheqëse i ka në tërësi nga të gjitha departamentet e institucionit në Lipjan;
- Sa pozita udhëhiqen nga gratë dhe sa pozita udhëhiqen nga burrat për secilin departament;
- Sa është buxheti vjetor për paga, si dhe sa përfitojnë gratë dhe burrat nga buxheti vjetor për paga, në formë (monetare), për secilin departament;
- Të specifikohet paga për secilën pozitë udhëheqëse të departamenteve si për burrat ashtu edhe për gratë;

Për shkak të mbrojtjes së të dhënave personale për secilin individ ne kemi kërkuar që emri dhe mbiemri i personave të jetë i mbrojtur, por të identifikohen përmes gjinisë dhe pozitës së të punësuarve si dhe pagese për këto pozita.

Metodat të cilat janë përdorur për këtë analizë janë disa metoda të cilat kanë mundësuar mbledhjen e informatave dhe përpunimin e tyre dhe kanë shërbyer për vlerësimin dhe përshkrimin e rezultateve, po ashtu të cilat kanë pasqyruar pabarazinë gjinore në disa institucione lokale në komunën e Lipjanit.

Përmes metodës sasiore është synuar pasqyrimi i saktë i numrit të punësuarve dhe pozitat udhëheqëse në institucionet lokale, ku përmes analizës me perspektiv gjinore, vihet në pah pabarazia e të punësuarve në disa institucione si p.sh në administratën e drejtorisë së arsimit, administratën e komunës, në administratën komunale të shëndetësisë, në Gjykatën Themelore e Prishtinës dega në Lipjan dhe në fund në stacionin policorë në Lipjan.

Si metodë tjetër është përdorur intervistat me drejtorët si dhe përfaqësuesit e këtyre institucioneve të cilët janë përgjigjur në pyetjet të cilat kanë mundësuar të bëhet ky hulumtim.

ANALIZË E PËRFSHIRJES GJINORE NË DREJTORIN E ARSIMIT

Drejtoria Komunale e Arsimit në Lipjan është njëra ndër drejtorit më të rëndësishme në Komunën e Lipjanit andaj është përzgjedhur si traget për analizën e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, ku përmes kësaj analize hulumtuese janë pasqyruar të gjeturat rreth perspektives gjinore duke filluar nga numri i stafit të punësuarve në këtë drejtori e deri tek pozitat udhëheqëse.

Në Administratën e Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA), janë gjithsej 7 pozita të punësuarve, ku në mesin e këtyre pozitave, 3 ose 42.85 % prej tyre janë pozita udhëheqëse brenda kësaj drejtorie, pozita kryesore e kësaj drejtorie është pozita e drejtorit/reshe, e cila udhëhiqet nga një grua, pastaj është shefi i sektorit të cilin e udhëheq një burrë si dhe pozita

e tretë është zyrtarja e lartë financiare të cilën e udhëheq nga një grua, pra nga 7 të punësuarit në këtë në administratën e kësaj drejtori 4 gra dhe 3 burra. Ndërsa kemi 3 pozita udhëheqëse, 2 që udhëhiqen nga gratë dhe 1 nga burrat.

Nr. i të punësuarve në Administratën e Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Lipjanit



3



4

Pozitat udhëheqëse në DKA



1



2

Ndërsa, numri i përgjithshëm i të punësuarve në sektorin e arsimit në Lipjan është 1038 të punësuarve , duke përfshirë institucionet parashkollore dhe shkollore. Në këto institucione kemi 28 pozita udhëheqëse. Në mesin e këtyre 28 drejtorive kemi vetëm 5 drejtoresha gra ose 17.85 %, kurse 23 burra ose 82.15 %. Ndërsa, në pozitat e Zëvendësdrejtoreve kemi vetëm 4 pozita e të cilat dy menaxhohen nga burrat dhe dy nga gratë, pra mund të deklarojmë se është e vetmja pozitë në të cilën kemi barazi gjinore.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në këtë institucion i ndarë sipas perspektives gjinore, del që të jetë rreth 501 burra të punësuar ose 48.59 %, ndërsa kemi rreth 530 gra të punësuar ose 51.41 %, këtu kemi një numër më të madh të grave të punësuar me një diferencë prej 29 gra, por që nuk është e njëjta edhe në pozitat udhëheqëse.

Nr. i pozitave udhëheqëse në institucionet arsimore (shkolla/çerdhe) drejtor/zv drejtor



23



5

Pozitat e zëvendës drejtorit



2



2

Nr. I përgjithshëm i të punësuarve në arsim



501



530

Perspektiva gjinore në paga për të gjitha pozitat duke filluar që nga numri i të punësuarve të ndarë në kategorinë mësues, arsimtar, profesor si dhe drejtor janë pasqyruar në bazë të rrogës bazë të cilën kanë, duke mos përfshirë përvojën e punës si dhe kualifikimet e mundshme të secilës pozitë.

Tabela 1. Paga për pozitën e drejtor/esh

Çerdhe	Drejtor/esh
Koeficienti	7.1
Paga	418.60 euro
Zyrtar/re administrative	5.4
	314.00 euro
Edukatore	6.7
	393.00 euro
Motër edukatore	5.5
	320.00 euro
Shkollë fillore e mesme e ulët	Drejtor/esh
Koeficienti	7.8
Paga	453.50 euro
Zv. Drejtor/esh	7.2
	418.60 euro
Sekretar/re	6.3
	366.30 euro
Zyrtar/re administrative	5.4
	314.00 euro
Edukatore për para fillor	6.7
	393.00 euro
Mësues/se klase	7.2
	421.00 euro
Arsimtar/re	7.2
	421.00 euro
Shkolla e mesme	Drejto/esh
Koeficienti	8.4
Paga	488.40 euro
Zv. Drejto/esh	7.8
	453.50 euro
Sekretar/re	6.6
	383.80 euro
Zyrtar/re administrative	4.8
	279.00 euro
Profesor/resh	7.9
	459.00 euro



Në kuadër të institucioneve shkollore në Komunën e Lipjanit janë 32 pozita udhëheqëse, ku 23 prej tyre udhëhiqen nga burrat dhe vetëm 5 nga gra.

Ndërsa, në pozitën e zëvendësdrejtorit nga 4 pozita, 2 udhëhiqen nga burrat dhe 2 nga gratë.

Tabela 2. Drejtoria e Arsimit në komunën e Lipjanit pozitat udhëheqëse

Drejtor/esh	?
Udhëheqës/e për arsim (shef sektori për arsim)	7.5 436.00 euro
Udhëheqës/e për financa (zyrtar i lartë)	8.0 465.12 euro
Zyrtar/e (për arsim, çështje juridike, financa etj)	6.0 348.84 euro

Në administratën e drejtorisë Komunale të Arsimit në Lipjan, janë gjithsej 3 pozita udhëheqëse. Kemi pozitën udhëheqëse të drejtorisë dhe zyrtaren e financave, gra.


ANALIZË E PËRFSHIRJES GJINORE NË DREJTORIN E SHËNDETËSISË

Në kuadër të Administratës së Drejtorisë së Shëndetësisë janë gjithsej 2 të punësuar, 1 ose 50 % prej tyre janë burra dhe 1 grua ose 50 %, e cila është drejtoresh e kësaj drejtorie, ndërsa nga pozita udhëheqëse në sektorin e shëndetësisë duke përfshirë institucionet QKMF-të, AMF-të, SHK-në dhe QPS-në janë 11 pozita udhëheqëse, ku 7 ose 63.64 % pozita menaxhohen nga burrat ndërsa 4 ose 36.36 % menaxhohen nga gratë. Në Sektorin e shëndetësisë në Lipjan i kemi 4 pozita që menaxhohen nga gratë duke i përfshirë dy drejtoresha njëra në QPS dhe tjetra në Shtëpinë e komuniteteve. Andaj nga ajo që mund të theksohet përmes këtyre të dhënave del se burrat kanë më shumë pozita udhëheqëse se gratë, prandaj rekomandohet që në vitet e ardhshme që përmes mekanizmave ligjore do të duhet të hartohen strategji e cila do të ndihmonin në ngritjen e pjesëmarrjes së grave në pozitat udhëheqëse.

Nr. i të punësuarve në Administratën e Drejtorisë së Shëndetësisë në Komunën e Lipjanit



1



1

Pozitat udhëheqëse në SHK, QKMF/QPS



7



4

Numri total i të punësuarve në sektorin e shëndetësisë në Lipjan është 227 të punësuar, duke mos e përfshirë edhe stafin e Qendrës për punë sociale si dhe stafin e Shtëpisë së komuniteteve, nëse i përfshijmë edhe këto atëherë numri total i të punësuarve arrin në 249. Në këtë sektori kemi 135 ose 59.47 % gra të punësuar dhe 92 ose 40.53 % burra, andaj në të ardhmen drejtoria e shëndetësisë do të duhet të hartonte strategji ku do të ngritë numrin e burrave të punësuarve, ndërsa në QPS nga 11 të punësuarve 8 ose 72.72 % janë gra ndërsa 3 ose 27.27 % janë burra, po ashtu edhe në shtëpinë e komuniteteve kemi 7 ose 63.63 % gra të punësuar dhe 4 ose 36.36 % burra, andaj edhe në këto dy departamente në kuadër të shëndetësisë do të duhej që të hartohen strategji të cilat do të ndihmonin në barazinë gjinore për 5 vitet e ardhshme.

Stafi i të punësuarve në shëndetësi

Shëndetësi



92



135

Qendra për punë social



3



8

Shtëpia e komuniteteve



4



7

Perspektiva gjinore në paga për të gjitha pozitat duke filluar që nga numri i të punësuarve të ndarë në kategorinë janë pasqyruar në bazë të rrogës bazë të cilën kanë, duke mos përfshirë përvojën e punës si dhe kualifikimet e mundshme të secilës pozitë.

Tabela 3. Paga për pozitën e drejtor/esh	
Drejtor/esh	?
Drejtor/esh i QKMF-së	Drejtor/esh
Koeficienti	12
Paga	944.93 euro
Shef i shërbimit të mjekëve	9.6
	754.01 euro
Koordinator i cilësisë	9.6
	754.01 euro
Kryeinfermier	7.2
	754.01 euro
Udhëheqës i DSHPS-së	523.36 euro
Drejtor i QPS-së	565.29 euro
U.d. menaxher i shtëpisë në komunitet	633.91 euro

Tabela 7 paga për pozitën udhëheqëse në drejtorin e shëndetësisë

Perspektiva gjinore për pagat për stafin e të punësuarve në shëndetësinë ku gjithsej janë 227 të punësuar në drejtorin e shëndetësi, nga 227 sa janë të punësuar 135 janë të punësuar gra në këtë dikaster dhe 92 janë të punësuar burra.

Tabela 4. Paga e stafit të shëndetësi në komunën e Lipjanit	
Emërtimet e pozitive të zyrtareve publike ne QKMF-Lipjan	Paga bruto
Udhëheqëse e Mjekëve në Mjekësi Familjare	754.01 euro
Kryeinfermiere	565.51 euro
Zyrtare e Lartë e Personelit	483 euro
Dr.Specialiste te Mjekësisë familjare	659.77 euro
Mjeke te Pergjithshme	565.51 euro
Mjeke te Stomatologjis	565.51 euro
Infermiere	425.34 euro

Nga 11 pozita udhëheqëse në drejtorin e shëndetësi, 8 pozita menaxhohen nga burrat dhe 3 nga gratë.

Në sektorin shëndetësisë në Komunën e Lipjanit nga 227 të punësuar, 135 jenë gra


Trajnerë e infermierisë/Këshillimore si dhe ndihmese trajnere	425.34 euro
Teknike te RTG dhe teknike te laboratorit	425.34 euro
Infermiere	377.00 euro
Mamia	377.00 euro
Asistente Administrative e Drejtorit te QKMF-së	377.00 euro
Arhiviste	377.00 euro
Rrobalarë ne QKMF	377.00 euro
Punëtore të mirëmbajtjes(pastruese)	314.17 euro
Fakturiste	377.00 euro

Tabela 8 pagat për stafin e shëndetësi

ANALIZË E PËRFSHIRJES GJINORE NË DREJTORIN E ADMINISTRATËS

Në Drejtorinë e Administratës komunal kemi 16 pozita udhëheqëse sa ka kjo drejtori, 9 ose 56.25 % prej tyre udhëhiqen nga burrat ndërsa 7 ose 43.75 % të tjera i udhëheqin gratë, andaj në këtë drejtori më shumë përfitojnë burrat se sa gratë, kështu kjo drejtori në të ardhmen do të duhej që të hartoj një strategji e cila do ti ndihmonte që në 3 ose 5 vitet e ardhshme të ngritë numrin e pozitave udhëheqëse nga gratë.

Nr. i pozitave udhëheqëse në drejtorin e administratës në komunën e Lipjanit



Ndërsa, numri i të punësuarve në Drejtorin e Administratës Komunale në Lipjan janë 210 të punësuar, 64 ose 30.48 % gra dhe 146 ose 69.52 % burra, edhe këtu pasqyrohet pa barazia gjinore mes burrave dhe grave në këtë dikaster ku kemi një numër i theksuar të burrave të punësuar. Në kuadër të administratës për dallim prej grave e që nuk është as 40 përqindja e të punësuarve gra në këtë dikaster, andaj i rekomandohet kësaj drejtorie që të punoj me një strategji në ngritjen e numrit të grave.

Nr. i stafit të punësuarve në administratën komunal



64



146

Paga përmes perspektives gjinore në drejtorinë e administratës për pozitat udhëheqëse ku totali i këtyre pozitave është 16 pozita udhëheqëse ku prej tyre 7 pozita udhëhiqen nga gratë ndërsa 9 pozita udhëhiqen nga burrat në këtë drejtori për sa i përket numrit të pozitave udhëheqëse përmes perspektives gjinore atëherë edhe në këtë drejtori përfitues janë burrat më shumë se gratë.

Tabela 5. Pagat në pozitat udhëheqëse në administratë komunal

Z.KRYETARIT	573.66 euro
ADMINISTRATA	523.36 euro
Zyra e komuniteteve	648.71 euro
Shërbimet sociale	565.29 euro

ANALIZË E PËRFSHIRJES GJINORE NË GJYKATËN THEMELORE TË PRISHTINËS DEGA NË LIPJAN

Hulumtimi i perspektives gjinore ka pasur traget edhe gjykatën themelore të Prishtinës dega në Lipjan si institucion publik i cili vepron në komunën e Lipjanit ku përmes kësaj analize janë pasqyruar pa barazitë në numrin e të punësuarve në këtë institucion si dhe pozitat udhëheqëse të cilat janë në Gjykatën Themelore të Prishtinës dega në Lipjan.

Numri i të punësuarve në gjykatën themelore të Prishtinës dega në Lipjan arrin në 43 të punësuar ku nga 43 të punësuar prej tyre janë 21 ose 48.84 % gra dhe 22 ose 51.16 % janë burra. Andaj në aspektin e perspektives gjinore në këtë institucion mund të deklarojmë se për sa i përket numrit të punësuarve kemi një barazi të lehtë gjinore brenda institucionit të Gjykatës Themelore të Prishtinës dega në Lipjan.

Tabela 6. Nr. i të punësuarve në Gjykatën Themelore të Prishtinës dega në Lipjan

Emri i institucionit	Burra	Gra	Totali
Gjyqtar	5	1	6
Ndihmës Administrator	1	0	1
Bashkëpunëtor Profesional	1	1	2
Sekretarë Juridike	0	6	6
Referent	2	4	6
Dorëzues	3	0	3
Vozitës	1	0	1
Mirëmbajtës	1	0	1
Sportelist	1	0	1
AJTI	1	0	1
Pastrues	0	2	2
Punëtor Sigurimi	5	0	5
Arkivist	1	2	3
Arkëtarë	0	2	2
Përkthyes	0	1	1
Zyrtare Ligjore	0	2	2

Ndërsa në Gjykatën Themelore dega në Lipjan kemi 2 pozitat udhëheqëse, gjyqtarin mbikëqyrës dhe ndihmës administratorin, këto dy pozita udhëhiqen nga burrat pra nuk ka pozitë në degën e Lipjanit e cila udhëhiqet nga gratë.

Pozitat udhëheqëse në gjykatën themelore dega në Lipjan

Gjyqtar Mbikëqyrës



1



0

Ndihmës Administrator



1



0

Ndërsa pagat në gjykatën themelore dega në Lipjan sipas pozitave janë si në vijim

Tabela 7. Të ardhurat sipas pozitës në gjykatën themelore dega në Lipjan

Emri i institucionit	Paga
Gjyqtar	1860 euro
Ndihmës Administrator	590 euro
Bashkëpunëtor Profesional	590 euro
Sekretarë Juridike	448 euro
Referent	470 euro
Postier shtëpiak	380 euro
Vozitës	450 euro
AJTI	460 euro
Pastrues	360 euro
Punëtor Sigurimi	368 euro
Arkivist	408 euro
Arkëtar	430 euro
Përkthyes	520 euro
Zyrtare Ligjore	470 euro

Me pagën prej 1860 euro përfitues janë 5 burra ndërsa është vetëm një grua, me pagën prej 590 euro përfitues janë 2 burra dhe një grua, me pagën prej 470 euro përfitues janë 2 burra si dhe 6 gra, me pagën prej 448 euro përfitues janë 6 gra dhe 0 burra.

Në tabelën 7 tregohet se në GjTHP dega në Lipjan, burrat dhe gratë janë të përfaqësuar në mënyrë të barabartë (21 ose 48.84 % gra dhe 22 ose 51.16 % janë burra). Në këtë mënyrë, burrat/gratë përfitojnë po thuajse njëjtë.

ANALIZË E PËRFSHIRJES GJINORE NË STACIONIN POLICOR TË KOMUNËS SË LIPJANIT

Numrit i të punësuarve në Stacionin Policor të Lipjanit arrin në 128 të punësuar ,ku prej tyre 27 ose 21.09 % janë gra dhe 101 ose 78.91 % janë burra, ndërsa struktura graduese në këtë institucion është si në vijim kapiten, toger, rreshter, polic, polic i ri si dhe staf civil. Ajo që vlen të theksohet se në stacionin policor nuk ka as një pozitë udhëheqëse nga gratë përveç pozitës së sheshe të resurseve të stafit civil e cila është grua.

Nr. i të punësuarve në stacionin policor të Kosovës në Lipjan



Tabela 8. Struktura e gradave në Stacionin Policor në Lipjan

Kapiten	1
Toger	2
Rreshter	9
Polic	78
Polic i ri	26
Staf civil	12

Tabela 16 struktura e gradave në policin e Kosovës

Zyra për komunikim në stacionin e policisë së Kosovës në nivel nacional nuk i ka dërguar të dhënat për paga në stacionin policor të Kosovës dega në Lipjan.

PËRFUNDIMET

Target i kësaj analize hulumtuese për Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor në institucionet e Komunës së Lipjanit me perspektive gjinore, ka qenë identifikimi i shpenzimeve të këtyre institucioneve lokale dhe sa kane përfituar gratë dhe burrat prej këtyre shpenzimeve.

Perspektiva gjinore në sektorin e punësimit në Drejtorin e Arsimit, Shëndetësisë dhe në Gjykatën Themelore të Prishtinës dega në Lipjan, në bazë të hulumtimit dhe të analizës kemi një përfaqësim të grave me të mire në krahasim me burrat, ku në të tri këto institucione kemi më shumë gra të punësuar, ku tregohet se ka një progres rreth ngritjes së numrit të grave të punësuar në institucionet komunale të Lipjanit

Ndërsa, në Drejtorin e Administratës si dhe në Stacionin e Policisë së Kosovës dega në Lipjani kemi një numër më të vogël të grave të përfaqësuar në sektorin e punësimit në këto institucione, andaj rekomandojmë që në të ardhmen do të duheshin të krijoheshin politika të cilat do të ndihmonin në barazinë gjinore në sektorin e punësimit.

Pozitat udhëheqëse në institucionet lokale në Lipjan, përmes analizës me perspektive gjinore, nuk kemi një përfaqësim të grave të kënaqshme, ku përveç dy drejtorive të cilat menaxhohen nga gratë, siç është drejtoria e Arsimit dhe ajo e

Shëndetësisë, ndërsa institucionet tjera menaxhohen nga burrat. Por edhe pozitat e tjera udhëheqëse brenda këtyre institucioneve menaxhohen më shumë nga burrat se sa nga gratë, ku kemi vetëm dy pozita udhëheqëse në drejtorin e Shëndetësi të cilat janë të menaxhuara nga gratë, si për shembull: QPS-ja dhe SHK-ja, ndërsa në të gjitha pozitat tjera ka një numër më të madhe të burrave në krahasim me gratë, përmes këtij hulumtimi del se burrat përfitojnë më shumë nga buxheti i komunës së Lipjanit se sa gratë pasi që kemi numër më të madh të burrave në pozitat udhëheqëse.

YAHR në të ardhmen rekomandon që të hartohen strategji të cilat do të ndihmonin drejtorin e Administratës dhe Stacionin e Polices së Kosovës në Lipjan që të përmirësonin pozitën e gruas në sektorin e punësimit e në veçanti në pozitat udhëheqëse, të cilat qëndrojnë me keq në krahasim me burrat, por edhe institucionet tjera duhet të hartojnë strategji të cilat do të përmirësonin pozitat udhëheqëse nga gratë pasi që qëndrojnë më keq në krahasim me burrat të cilët kanë më shumë pozita udhëheqëse kështu që në 3 ose 5 vitet e ardhshëm secili institucionet duhet të parasheh rritjen e numrit të grave në pozitat udhëheqëse për ta arritur barazinë gjinore këtu mund të përdorën edhe masat afirmative në baze të Ligjit për barazi gjinor.

Rekomandim i dytë i këtij hulumtimi është që në të ardhmen Komuna e Lipjanit por edhe institucionet tjera si Gjykata Themelore e Prishtinës dega në Lipjan, Stacioni Policore në Komunën e Lipjani të bëjnë analiza me perspektive gjinor në të gjitha departamentet apo dikasteret e këtyre institucioneve dhe përmes atyre të gjeturave të arrijini të krijojnë strategji të cilat do të ndihmonin në barazinë gjinore dhe njëherësh të respektohet ligji për barazi gjinore.

PËRSHKRIM PËR ORGANIZATËN

Asociacioni i të Rinjve për të Drejtat e Njeriut (YAHR) është organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse, e themeluar në fillim të vitit 2000 por ajo është regjistruar vetëm në 21 Tetor 2002 në nivelin qendror. Nisma për krijimin e organizatës ishte nevoja për të ndërtuar një shoqëri demokratike me mundësi të drejta dhe të barabarta për të gjithë qytetarët. Të drejtat dhe mundësitë e barabarta në një shtet demokratik shkojnë së bashku me përgjegjësitë qytetare që secili qytetar i jep vendit dhe shtetit të tij. Duke u bërë pjesë e shoqërisë, ne përpiqemi të luajmë një rol aktiv në përmirësimin e jetës së qytetarëve përmes mbikëqyrjes së qeverisë dhe presionit për të prodhuar politika të mira publike të cilat synojnë të përmirësojnë jetën e të gjithë qytetarëve pa diskriminim.

Përgjatë viteve të funksionimit si një nga organizatat më aktive lokale, YAHR është profilizuar si një entitet mbikëqyrës (Watchdog) duke mirëmbajtur kontrollin efektiv publik, fillimisht mbi Komunën e Lipjanit, e me kalimin e viteve edhe në ato të Shtimes dhe Ferizajit. YAHR është specializuar në monitorimin e punës së organeve komunale (legjislativ dhe ekzekutiv) dhe ka prodhuar një numër të madh raportesh që dëshmojnë për ecurinë e qeverisjes lokale. Një nga ndikimet

kryesore të punës së YAHR ka qenë hapja e komunave në raport me qytetarët, pra fuqizimi i transparencës publike dhe në të njëjtën kohë rritja e kërkesës publike për më shumë llogari. Kjo qasje e organizatës ka ndikuar edhe në aktivizimin e grupeve të komunitetit në komunat përkatëse. Në komunën e Lipjanit është vërejtur rritje e interesimit qytetar, bashkë me formimin e grupeve të reja të komunitetit që kanë intensifikuar komunikimin me institucionet komunale, krahas rritjes së kërkesave.

YAHR beson që përgjatë këtyre viteve ka ofruar një kontribut të konsiderueshëm në avancimin e agjendës së demokratizimit në këto komuna, me theks në komunën e Lipjanit. Në të njëjtën kohë, organizata beson që ka shërbyer edhe si model për grupe të rinjsh, duke nxitur aktivizimin e tyre në çështje lokale që kanë rëndësi për komunitetin. Nuk duhet harruar as rolin që YAHR ka luajtur në nivel kombëtar, si pjesë e programeve të partneritetit, rrjeteve të shoqërisë civile dhe prezencës aktive mediale, në avancimin e demokracisë lokale. YAHR është e vetëdijshme që angazhimi i organizatave të shoqërisë civile është vështirë i matshëm në shtigje të shkurtra, pasi misioni i asaj pjese të shoqërisë civile që punon për demokratizim para se gjithash përkon me ndërrimin e mendësisë si të qytetarëve ashtu edhe të atyre që janë në pozita të pushtetit. Ndryshimi i kulturës së përgjithshme politike dhe shndërrimi i qytetarit në aktivistin që e sfidon në baza të rregullta pushtetin, si dhe shndërrimi i bartësit të një pozitë publike në shërbëtorin që në baza ditore kujdeset për cilësinë e shërbimeve ndaj qytetarit, është sfidë sa komplekse, aq edhe e shtrirë në kohë.

